



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 30, Datë 22.01.2021

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 189/1/a, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 8, të Rregullores së KLP-së “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, pasi u njoh me kërkesën me nr. 07 Prot., datë 06.01.20201 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren zj. Albjona Papajani, si pedagoge e jashtme (asistente lektore), për lëndën “Krimi i Organizuar”, në programin e studimit Master Profesional, për vitin akademik 2020-2021 pranë “Albania University”. Ngarkesa mësimore do të jetë 1 orë në javë, 15 orë gjatë gjithë semestrit, pas orarit zyrtar të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim znj. Albjona Papajani dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
VATË STAKAJ



ANËTAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
ESMERALDA KESHI

